



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



z. Ahmet QERIQI  
RADIO Kosova e Lirë  
Pronar/Drejtor  
“Radio Kosova e Lire”  
Rr/ Thimi Mitko, nr.6  
Prishtinë

Ref: 1502/171/LIC/ni

24 shkurt 2015, Prishtinë

Për zbatim të plotë të Rregullores KPM-2014/03, Komisioni merr këtë:

### VENDIM

për ndryshimin e kategorisë së mbulueshmërisë për të licencuarin RADIO Kosova e Lirë,  
me seli në Prishtinë

---

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Më 30 dhjetor 2014, KPM ka miratuar Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë (Rregullorja KPM-2014/03), e cila ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë.
3. Neni 2 i Rregullores KPM-2014/03 përcakton në mënyrë specifike kriteret bazë për katër (4) kategoritë e shërbimeve mediale audiovizuale me frekuencë.
  - a) *Kategoria me mbulim nacional, i përket shërbimeve mediale audiovizuale të cilat, përmes rrjetit frekuencor të koordinuar në pajtim me planin frekuencor të Republikës së Kosovës për transmetim tokësorë, mbulojnë me sinjal radio televiziv mbi 80% të popullsisë së Republikës së Kosovës;*

- b) *Kategoria me mbulim regjional, i përket shërbimeve mediale audiovizuale të cilat mbulojnë me sinjal radio televiziv, përmes frekuencës, më shumë se tri komuna (15-30% të popullsisë së Republikës së Kosovës);*
  - c) *Kategoria me mbulim lokal, i përket shërbimeve mediale audiovizuale të cilat ofrojnë mbulim me sinjal radio televiziv, përmes frekuencës, deri në tri komuna (deri në 15% të popullsisë së Republikës së Kosovës);*
  - d) *Kategoria me fuqi të ulët transmetimi, i përket shërbimeve mediale audiovizuale të cilat transmetojnë, përmes frekuencës, me më pak se 50W fuqi transmetimi.*
4. Në bazë të definicioneve dhe kriterëve për kategorizim që janë përcaktuar në Rregulloren KPM 2014/03, RADIO Kosova e Lirë i përket kategorisë me mbulim regjional.

### Arsyetim

5. Në bazë të kriterëve që definojnë numrin e komunave apo përqindjen e mbulimit të popullsisë nga ana e një të licencuari të KPM-së (radio apo TV), sipas Rregullore KPM-2014/03, RADIO Kosova e Lirë, me seli në Prishtinë obligohet të ndryshojë kategorinë e mbulueshmërisë në pajtim me këtë rregullore, duke kaluar nga kategoria me mbulim lokal në kategorinë me mbulim regjional.
6. Ky ndryshim është bërë sipas rezultateve dhe analizës së bërë sa i përket mbulueshmërisë me sinjal të RADIO Kosova e Lirë dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara me rregulloren KPM-2014/03 sipas të cilave RADIO Kosova e Lirë mbulon më shumë se tre komuna si dhe më shumë se 15% të territorit të Republikës së Kosovës.
7. Ndryshimi i kategorisë së mbulueshmërisë për RADIO Kosova e Lirë është në pajtim me nenin 2, paragrafin 2 të Rregullore KPM-2014/03.
8. Gjithashtu, ndryshimi i kategorisë së mbulueshmërisë për RADIO Kosova e Lirë bëhet edhe në pajtim edhe me neni 16, paragrafi 2 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së i cili thekson se:
- “Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor”.*
9. Me ndryshimin e kategorisë së licencës sipas mbulueshmërisë, do të ndryshojë edhe niveli i pagesës së tarifës vjetore për licencë të KPM-së që TV Kosova e Lirë do të paguajë për vitin 2015.
10. Në rast se RADIO Kosova e Lirë e ka kryer pagesën e tarifës vjetore për vitin 2015, para marrjes së këtij vendimi, i njëjti do të obligohet të paguaj pjesën shtesë të tarifës si




rezultat i ndryshimit të kategorisë nga shërbim medial me mbulim lokal në shërbim medial me mbulim regional, në pajtim me rregulloren KPM-2014/03.

### Vendim

11. Në mbledhjen e datës 24 shkurt 2015, Komisioni ka marr vendim për ndryshimin e kategorisë së mbulueshmërisë për RADIO Kosova e Lirë duke u bazuar në nenin 2 të Rregullores KPM-2014/03.
12. Komisioni merr vendim për ndryshimin e Certifikatës së Licencës së RADIO Kosova e Lirë duke përcaktuar që RADIO Kosova e Lirë është shërbim medial audiovizual i kategorisë me mbulim regional.
13. Komisioni merr vendim që pagesa vjetore e tarifës për licencë për vitin 2015 të bëhet në pajtim me nenin 5 të Rregullores KPM-2014/03, sipas kategorisë së ndryshuar për RADIO Kosova e Lirë, dhe nëse aplikohet, të kërkohet nga i licencuari që të kryej pagesën e dallimit të taksës nga kategoria me mbulim lokal në atë me mbulim regional.

### Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. I licencuari obligohet të kryej pagesën e plotë të taksës deri në fund të muajit mars 2015.



Adnan MEROVCI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



26.02.2015

datë